

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 29
16.12.2014

NR. VENDIMI 26
19.12.2014

V E N D I M

«Për Sekuestrim Pasurie»

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

GJYQTARE: Liljana BAKU

Asistuar nga sekretare séance **Blerina SUKAJ**, sot në datë 19.12.2014, ora 10.00 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr.29 Regj. me:

KËRKUESE:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Ened NAKUÇI**, me Autorizimin datë 19.12.2014, të titullarit të institucionit.

KUNDËR:

Shtetasit E.M.N., i datëlindjes xxx, shtetas xxx, me dokument identifikimi Nr.xxx.

Shtetases nën hetim, R.K., e bija e D., e datëlindjes xxx, lindur në xxx dhe banues në xxx, xxx, me shtetësi shqiptare, me dokument identifikimi xxx.

Shtetasit B.Ç., i biri i M., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx, me shtetësi shqiptare, me dokument identifikimi Nr.xxx.

OBJEKTI:

Sekuestrimin e pasurive të luajshme, si më poshtë:

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të R.D.K., në shumën xxx lekë.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të R.D.K., në valutë, me gjendjen xxx Euro.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të B.
M.Ç., në shumën xxx lekë.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të B.
M.Ç., me gjendje xxx euro.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të B.
M.Ç., me gjendje xxx GBP.

II. Për për administrimin e pasurive të luajshme të ngarkohet Z.E.B., i cili është administrator në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Gjyqësor xxx.

BAZA LIGJORE:

Nenet 3 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 «Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë».

Në përfundim të gjykimit gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi dëgjoi pretendimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

V Ë R E N

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë xxx, regjistroi procedimin pasuror Nr.xx, Viti xxx, në ngarkim të shtetasve E.N., R.D.K. dhe B.M.Ç., pasi shtetasja R.K. ishte shtetase e dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ndërsa shtetasit E. dhe B. kishin ndikuar në veprimtarinë e jashtëligjshme të saj. Procedimi pasuror ishte rrjedhojë e procedimit penal Nr.xxx Viti xxx, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx.

Nga materiali hetimor, që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx i dërgoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, rezultoi sa më poshtë:

Shtetasi xxx E.M.N., në datë xxx, transferoi në Llogarinë në euro, me Nr.xxx, në emër të shtetasit B.Ç., në Bankën xxx, Dega xxx, shumën prej xxx Euro. Në të njëjtën numër llogarie dhe nga i njëjti person, nëpërmjet Bankës “xxx”, në datë xxx, u transferua shuma prej xxx euro.

Shtetasi xxx E.M.N., në datë xxx, po nëpërmjet Bankës “xxx”, transferoi në Llogarinë në euro, me Nr.xxx, në emër të shtetases R.K., në Bankën xxx, Dega xxx, shumën prej xxx Euro.

Nga data xxx deri në datë xxx, B.Ç. tërhoqi nga llogaria e tij xxx euro, ndërsa pjesën tjetër e transferoi, në datat xxx dhe xxx, në llogarinë në euro të shtetases R.K.

Nga shumat e transferuara prej shtetasit B.Ç. në llogarinë e shtetases R.K., kjo e fundit, nga data xxx deri në datë xxx tërhoqi shumën prej xxx euro, ndërsa pjesa e mbetur dhe shuma prej xxx euro, transferuar në llogarinë e saj prej shtetasit xxx E.M.N., u sekuestrua me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, datë xxx (për një afat tre mujor).

Mbi bazën e Shkresës Nr.xxx Prot datë xxx, Banka xxx njoftoi se gjendja aktuale në llogarinë bankare të shtetases R.K. me Nr.xxx ishte xxx lekë, ndërsa në llogarinë bankare me Nr.xxx ishte xxx Euro.

Për shtetasin B.Ç., sipas informacioneve bankare, Shkresës Nr. xxx Prot. datë xxx, rezultoi se gjendja në llogarinë bankare me xxx ishte xxx lekë, në llogarinë me Nr.xxx ishte xxx euro, në llogarinë me Nr.xxx ishte xxx GBR. Gjithashtu për këtë shtetas, rezultoi një llogari bankare në Bankën ”xxx” me gjendje të përpërfillshme dhe, në Bankën «xxx» një llogari rrjedhëse bashkëmërore me L.M. (nënë e tij).

Nga verifikimet e kryera në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shtetasit R.K. dhe E.N. nuk rezultuan të kishin prona të regjistruara, ndërsa B.Ç. një pronë në xxx, të përfituar nga nena e tij L.M.

Në datat xxx dhe xxx, shtetasit R.K. dhe E.M.N., u paraqitën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx ku dhanë deklaratimet e tyre në lidhje me transfertat e kryera. Ata deklaruan se ishin bashkëjetues me njëri tjetrin dhe banonin në xxx, në adresën “xxx” Nr.xx, Kodi Postar xxx dhe, se E. ishte me profesion infermier, i punësuar në azilin e pleqve “xxx”, xxx. Në datë xxx, ata do të celebroheshin me martesë në Zyrën e Gjendjes Civile xxx.

Sipas deklaruësve, njiheshin me njëri tjetrin prej një viti dhe arsyeja që E.

transferoi në favor të R. shumën e parave të sipërcituara, kishte të bënte me planet e tyre për blerjen e një shtëpie të mirë dhe hapjen e një biznesi, si restorant apo supermarket.

Shuma e parave prej xxx euro, transferuar nga E. tek R., nëpërmjet shtetasit B.Ç., sipas deklaruës R.K., ishte kryer për shkak se ajo në atë kohë nuk kishte ende një llogari bankare, ndërsa B. ishte shoku i ish të dashurit të saj, që nuk jetonte më.

Shumat e parave të transferuara, sipas deklaruësve, u siguruan nga shitja e aksioneve që E. kishte patur në shoqëritë “xxx”, “xxx” dhe “xxx”, me qendër në xxx dhe objekt të veprimtarisë telekomunikacionin, supermarket, farmaci etj, të trashëguara nga prindërit e tij.

Për shtetasen R.K., mbi bazën e informacioneve të Zyrës Qëndrore Kombëtare Interpol xxx, u morën të dhëna për implikim të saj në aktivitetin kriminal në fushën e favorizimit të prostitucionit, pasi autoritet xxx njoftuan për kryerje prej saj të veprimeve të tilla si nxitje të gjesteve të pahijshme, nxitje të prostitucionit, martesë të simuluar, fallsifikim dokumentash etj. Njëkohësisht ajo dyshohet për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Martesa e saj me shtetasin xxx E.N. u lidh pas regjistrimit të procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, pasi ngriti dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova (sipas saj) se, transaksionet financiare në shuma të mëdha eurosh, të kryera brenda një kohe të shkurtër, nga një person i vetëm nga jashtë Shqipërisë (burimi i të cilave është i panjohur), një pjesë në drejtim të R. dhe një pjesë në drejtim të B.Ç., duke mos patur midis tyre lidhje të identifikuar familjare dhe të dhëna për përfitime nga biznese, shit-blerje pasurish të paluajtëshme, përbënin indicje për përfshirje të shtetasës R.K. në veprimtari kriminale, vendosi masën e sekuestros preventive mbi llogaritë bankare, të sipërcituara, në funksion të procedimit penal Nr.xxx Viti xxx.

Gjithashtu, pasi çmoi se ndodhej para rasteve të parashikuara nga Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, materialin hetimor i’a kaloi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Me marrjen e akteve nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në vlerësim të tyre,

ngriti dyshimin se shumate e parave të depozituara në llogari bankare, në emër të R.K., janë përfituar prej saj si rezultat i përfshirjes, së bashku me bashkëjetuesin e saj, E.N. (dhe aktualisht bashkëshort) në veprimtarinë kriminale të favorizimit të prostitucionit, duke kryer njëkohësisht edhe pastrim të produkteve të veprës penale. Pasuritë nuk i përgjigjeshin nivelit të të ardhurave të të dyshuarës dhe familjarëve të saj dhe, se ekzistonte rreziku i humbjes apo tjetërsimit për shkak të ndonjë revokimi të mundshëm të sekuestros preventive ose mbarimit të afatit. Sipas saj, R.K., në kushtet e ekzistencës së dyshimit për përfshirje në veprimtarinë kriminale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale, bazuar në nenin 3 pika 1 gërma “d” të Ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” është subjekt i zbatimit të tij. Gjithashtu, bazuar në nenin 3 pika 2 të Ligjit në fjalë, edhe shtetasit E.N. e B.Ç. janë subjekte të zbatimit të tij pasi me veprimet e tyre kanë ndihmuar në lehtësimin e kryerjes së veprimtarisë kriminale nga personi i dyshuar R.K.

Në datë xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë paraqiti para kësaj Gjykate, kërkesën me objekt sekuestrimin e llogarive bankare, të përshkruara më sipër, duke patur si bazë ligjore Ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të Ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur.

Në kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori i autorizuar i qëndroi pretendimeve në lidhje me dyshimet e ngritura për shtetasen R.K. dhe bashkëjetuesin e saj (aktualisht bashkëshort), në lidhje me faktin që pasuritë nuk justifikoheshin nga të ardhurat dhe për ekzistencën e rrezikut të tjetërsimit apo humbjes.

Në funksion të provueshmërisë së pretendimeve dhe kërkesës në gjykim, prokurori paraqiti si provë aktet që kishin të bënin me regjistrimin e procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, përfshirë edhe vendimin e gjykatës, pranë kësaj prokurorie, për vendosjen e sekuestros preventive; dokumentet bankare ku dokumentohej çelja e llogarive dhe transaksionet e kryera me to; të dhënat e marra nga bankat e nivelit të dytë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme në rrethe, në lidhje me depozita apo pasuri të paluajtëshme në emër të shtetasve R.K., E.N. dhe B.Ç., informacionet e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit për

shtetasin xxx dhe dokumentat bankare të dorëzuara pranë organit procedues (prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx) nga vetë shtetasi E.N. Gjithashtu, në seancë gjyqësore u paraqit edhe Urdhëri për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, datë xxx, disponuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, sipas të cilit emri i shtetasës R.K. u shënua në regjistrin e njoftimit të veprave penale për procedimin penal Nr.xxx/xxx.

Gjykata në analizë të pretendimeve të prokurorit dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet për këto arsye:

I.Kërkesa u paraqit në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”.

Në pikën 1 gërma “d” të Ligjit parashikohet zbatimi i tij për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje, për kryerjen prej tyre të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në pikën 2 gërma “a” parashikohet zbatimi i ligjit edhe mbi pasuritë e personave të afërm të të dyshuarve për kryerje të veprave penale të parashikuara në pikën 1, ndërsa në gërmën “b”, ndërmjet të tjerave, edhe mbi pasuritë e personave fizikë që në një formë apo në një tjetër kanë ndikuar në veprimtarinë e jashtëligjshme të personave të parashikuar në pikën 1.

U provua në gjykim se shtetasja R.K. është shtetase nën hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, për të cilën është duke proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, ndërsa shtetasi xxx E.N. është bashkëjetuesi i saj (aktualisht bashkëshort) dhe shtetasi B.Ç., nëpërmjet pranimit në llogarinë e tij bankare të shumave të parave, të transferuara nga xxx, nga shtetasi E.N. dhe kalimit, më pas, në llogarinë bankare të shtetasës R.K., ka ndikuar në realizimin e veprimtarisë kriminale për të cilën dyshohet kjo e fundit.

Dyshimet e ngritura në shtetin belg për veprimtari kriminale të shtetasës R.K. në fushën e shfrytëzimit të prostitucionit; Transferimi, brenda një kohë të shkurtër, i shumave të konsiderueshme të parave nga xxx në Shqipëri prej shtetasit xxx E.N., bashkëjetues i R.K., në llogarinë e shtetasit B.Ç., duke mos patur asnjë lidhje me të; Deklarimi, prej shtetasve E. dhe R. si burim të shumave të parave aksionet e trashëguara nga prindërit e E., duke mos u provuar një fakt i tillë,

Transferimi më pas, i copëzuar, i shumave të parave nga llogaria e B. në llogarinë e R.K.; Mungesa e ndonjë aktiviteti tregëtar, të regjistruar në emër të tyre apo familjarëve; Mungesa e pasurive të palujtëshme, nga të cilat të mund të gjenerohen të ardhura, çmohen nga gjykata si indicje të rëndësishme mbi bazën e të cilave ngrihet dyshimi për kryerje, nga shtetasja R.K., të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, vepër kjo e përfshirë në rrethin e veprave penale për të cilat bën fjalë pika 1 e Ligjit. Shtetasja R.K. është subjekte e zbatimit të Ligjit për shkak të dyshimeve që rëndojnë mbi të, për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale” dhe, për pasojë pasuria e saj, i nënshtrohet masave të parashikuara në të. Subjekte të zbatimit të Ligjit janë edhe shtetasit E.N., jo vetëm për faktin e qënies si bashkëjetues me shtetasen e dyshuar R.K. por edhe të kontributit që ka dhënë në transferimin e shumave të parave nga xxx në Shqipëri si dhe, B.Ç. për ndikimin e tij në kryerjen e veprimtarisë së jashtëligjshme.

II. Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të Ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kriterëve të përgjithshme që kanë të bëjnë me: **1.** Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje që tregojnë se personat mund të jenë të përfshirë në veprimtari kriminale. **2.** Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe

Ekzistenca e të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Përsa më sipër, u arsyetua se mbi shtetasen R.K. rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicje, për përfshirje të saj në veprimtarinë kriminale të pastrimit të parave, (për të cilën është duke hetuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx), që mund të jenë produkte të një veprimtarie të jashtëligjshme të kryer prej saj në shtetin xxx. U provua gjithashtu se shtetasi xxx E.N., bashkëjetues i shtetasen nën hetim, transferoi shumat e parave nga xxx në llogarinë bankare të shtetasit B.Ç. dhe ky i fundit në llogarinë bankare të R.K.

Shtetasja R.K. dhe familjarët e saj nuk kanë të regjistruar asnjë aktivitet tregëtar dhe asnjë të ardhur tjetër të ligjshme, që të mund të justifikojë shumat e mëdha të eurove, të derdhura në llogari bankare (kriteri 2 i përgjithshëm). E njëjta gjë ka rezultuar edhe për dy personat e tjerë të përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit për shkak të lidhjes së afërt (E.) dhe të ndikimit në kryerjen e veprimtarisë së jashtëligjshme (E. dhe B.).

Ekziston rreziku real për tjetërsimin e llogarive bankare. Duke qënë se masa e sekuestros preventive është e kushtëzuar nga ecuria e procedimit penal dhe është caktuar me afat, në rast pushimi të tij ose të mbarimit të afatit, është e natyrshme që shtetasit R.K. dhe R.Ç. të bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i mbyllur ato me qëllim shmangien nga një konfiskim i mundshëm (kriteri i veçantë i parashikuar në gërmën "a" të pikës 1 të nenit 11). Ky rrezik bëhet edhe më evident pasi shtetasja nën hetim dhe personat e tjerë të njoftohen edhe për procedimin pasuror të nisur ndaj tyre dhe, për masën e sekuestros të vendosur nga kjo gjykatë.

Ndodhur para faktit të ekzistencës së masës së sekuestros preventive, bazuar në nenin 5 pika 3 e Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, pavarësisht mungesës së kërkesës nga ana e prokurorisë për pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros deri në dhënien e një vendimi gjyqësor për revokimin apo shuarjen e saj (sekuestros preventive), gjykata çmon se ka detyrimin ligjor për një urdhërim të tillë.

Në bazë të pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi gjykata vlerësoi praninë e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për vendosjen e masës së sekuestros, çmon se ekziston detyrimi që të njoftojë zotëruesit e pasurive të sekuestruara për vendimin e marrë prej saj. Në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Procedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore, vendimi i saj duhet t'i njoftohet shtetasës nën hetim R.K., shtetasit B.Ç. si dhe shtetasit tjetër E.N..

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë, kompetente për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë përmbauesit gjyqësorë dhe, për administrimin e tyre administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte, është detyrim ligjor për gjykatën që në vendimin e saj të urdhërojë zyrën e përmbaimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e luajtshme (neni 516 i Kodit të Procedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestros.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma "d", nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma "a", nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër

pasurisë”.

V E N D O S

Pranimin e kërkesës.

Vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë e luajshme të shtetasve R.K., E.M. N. dhe B.Ç., si më poshtë:

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të R.D.K., në shumën xxx lekë.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të R.D.K., në valutë, me gjendjen xxx Euro.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të B. M.Ç., në shumën xxx lekë.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të B. M.Ç., me gjendje xxx euro.

Llogarisë me Nr.xxx, në Bankën xxx, në emër të B. M.Ç., me gjendje xxx GBP.

Pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokim apo shuarje të masës së sekuestros preventive.

Për ekzekutimin e vendimit të sekuestros ngarkohet Zyra e Përmbartimit Gjyqësor xxx dhe, për administrimin e pasurisë së sekuestruar, administratori E.B., në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Urdhërohet K/Sekretaria, pranë kësaj Gjykate, t’u njoftojë shtetasve R.K., E.M.N. dhe B.M.Ç. vendimin e sekuestrimit.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall sot në Tiranë, në datë 19.12.2014 ora 10.30.

SEKRETARE
Blerina SUKAJ

GJYQTARE
Liljana BAKU